

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi zgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve (“Fleta zyrtare e RMZ” nr. 4/98, 5/98, 17/98, 14/00, 18/00, 09/01, 41/02, 46/02, 45/04 dhe “Fleta zyrtare e MZ”, nr. 48/06, 56/06, 46/11, 14/14 dhe 47/14) Komisioni komunal zgjedhor i Tuzit në seancën e mbajtur më 01.07.2020 ka sjell

RREGULLOREN E PUNËS SË KOMISIONIT KOMUNAL ZGJEDHOR

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së Komisionit komunal zgjedhor (në tekstin e mëtejme: Komisioni).

Neni 2

Selia e komisionit është në ndërtesën të cilën Komuna e Tuzit ka marrë me qira nga personi fizik Lucë Gjonaj, me adresë “Tuz p.n.”, Tuz, kati i I.

Neni 3

Komisioni ka vulën dhe vulën katrore të protokollit.

Vula është e formës së rrumbullakët, me tekst të shkruar në gjuhën zyrtare dhe gjuhën shqipe.

Në rrethin e parë përmban fjalët “Mali i Zi”. Në rrethin e dytë përmban fjalët “Komisioni komunal zgjedhor Tuz”. Në mes është stema e Malit të Zi.

Vula katrore e protokollit është e formës drejtkëndëshe me tekst “Komisioni komunal zgjedhor Tuz” me shënim për numrin e aktit, datën dhe vendin e pranimit. Teksti i vulës katrore është i shkruar në gjuhën zyrtare dhe gjuhën shqipe. Mbi ruajtjen e vulës dhe vulës katrore të protokollit të Komisionit përkujdeset sekretari i Komisionit.

Neni 4

Anëtarët e Komisionit në punën e komisionit kanë të drejtë që përveç gjuhës zyrtare të përdorin edhe gjuhën shqipe dhe boshnjake.

Të gjitha aktet e Komisionit do të hartohen në gjuhën zyrtare dhe gjuhën shqipe.

Komisioni për nevoja të përkthimit do të angazhojë personin ekspert.

Neni 5

Komisioni punon në përbërje të përhershme (anëtarët e emëruar) dhe të zgjeruar (anëtarët e autorizuar).

Anëtarët e komisionit në përbërje të zgjeruar marrin pjesë në punën e komisionit 20 ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve dhe përfundojnë me punë me ditën e përcaktimit të rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve.

Neni 6

Komisioni punon dhe vendos në seancë.

Komisionin në seancë thërret dhe propozon rendin e ditës kryetari i Komisionit, sipas iniciativës së vet ose me kërkesë të së paku tre anëtarëve të përbërjes së përhershme të Komisionit.

Komisioni, sipas rregullit thërret dhe materialin për seancën anëtarëve të Komisionit dorëzon jo më vonë se 24 orë para seancës dhe sipas nevojës Komisioni mund të thirret me telefon ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme kurse ftesën dhe materialin të dorëzojnë në vetë seancë.

Neni 7

Seancën e Komisionit kryeson kryetari, kurse në rast të mungesës së tij nënkryetari i kryetarit të Komisionit. Kryetari, gjegjësisht anëtari i Komisionit, në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes në seancë është i obliguar që në kohë të njoftojë zëvendësin e vet, si dhe sekretarin e Komisionit.

Zëvendëskryetari dhe zëvendësi i anëtarit të komisionit kanë të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi si kryetari gjegjësisht anëtari të cilin zëvendëson.

Sekretari i Komisionit është përgjegjës për realizimin e detyrave administrative të parashikuara në legjislacionin zgjedhor.

Neni 8

Komisioni mund të punojë nëse në seancë merr pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve, gjegjësisht zëvendës anëtarë të Komisionit, në përbërje të përhershme gjegjësisht në përbërje të zgjeruar.

Komisioni vendos me shumicën e numrit të përgjithshëm të anëtarëve kurse vendimet i sjellë me shumicën e votave të anëtarëve prezent.

Neni 9

Komisioni në punën e vet bashkëpunon me organet e administratës së komunës së Tuzit në fushëveprimin e të cilave janë edhe kryerja e punëve të caktuara lidhur me zbatimin e zgjedhjeve.

Neni 10

Komisioni mund të kërkojë nga organet e administratës së komunës së Tuzit njoftime dhe shpjegime, të cilat janë me interes për punë të Komisionit.

Neni 11

Seancës së Komisionit, me miratimin e kryetarit apo sekretarit të Komisionit, mund të prezantojë përfaqësuesi i organit të administratës së Komunës së Tuzit, kur në seancë debatohet çështja nga fushëveprimi i atij organi si dhe të punësuarit në shërbime dhe organe të cilët në pikëpamje profesionale dhe teknike sigurojnë zbatimin e zgjedhjeve si dhe bashkëpunëtorë të tjerë profesional.

Neni 12

Puna e Komisionit është publike.

Komisioni siguron punën publike me botimin e akteve dhe të dhënave të rëndësishme për zhvillimin e zgjedhjeve në faqen e internetit të Komisionit dhe në "Fletën zyrtare të Malit të Zi", si dhe lëshimin e njoftimeve për shtyp dhe organizimin e konferencave për shtyp.

Komisioni mund të ketë portparollin, të cilin në propozim të kryetarit të Komisionit e përcakton Komisioni nga përbërja e përhershme e Komisionit.

Deklaratat dhe konferencat për shtyp në komision mund të mbajë kryetari, dhe portparolli përderisa e emëron Komisioni. Në rast të mungesës së Kryetarit të Komisionit, njoftimin publik mund ta jap personin të cilin ai e autorizon.

Neni 13

Punët profesionale, administrative, teknike dhe punë të tjera për nevojat e komisionit, kryejnë shërbimet profesionale të organeve të Komunës së Tuzit dhe bashkëpunëtorët e tjerë.

Punët nga paragrafi 1 i këtij neni, mund ti kryejnë edhe personat e tjerë me miratimin e kryetarit ose në propozim të sekretarit të Komisionit.

Neni 14

Për nevoja të studimit të çështjeve të veçanta nga fushëveprimi i tij, hartimi i propozimit të akteve, raporteve dhe dokumenteve të tjera, Komisioni mund të formojë një trup punues nga radhët e anëtarëve të Komisionit dhe mund të angazhojë edhe ekspertë të cilët, sipas nevojës, mund të marrin pjesë në seancat e Komisionit.

Neni 15

Mbi ankesat të cilat janë parashtruar Komisionit, kryetari dhe sekretari i Komisionit, në bashkëpunim me punëtorët ekspert të cilët sipas nevojës mund të angazhojë Komisioni, përgatitë për nevoja të Komisionit mendimin mbi mënyrën e zgjidhjes së ankesës.

Mendimi nga paragrafi 1 i këtij neni përfshin përmbajtjen e ankesës, gjendjen faktike, theksimin e dispozitave ligjore në bazë të të cilave është zgjidhur ankesa dhe propozimin se si të zgjidhet.

Neni 16

Komisioni në punën e vet bashkëpunon me organet e administratës së komunës dhe organizatat komunale në fushëveprimin e të cilave përfshihet kryerja e detyrave të caktuara lidhur me udhëheqjen e zgjedhjeve.

Komisioni në punën e vet në veçanti bashkëpunon me Komisionin shtetërorë zgjedhor.

Nga ana e Komisionit shtetëror zgjedhor, Komisioni mund të kërkojë mendime dhe interpretime mbi çështje të caktuara.

Komisioni është i obliguar të zbatojë udhëzimet dhe vendimet e Komisionit shtetërorë zgjedhor.

Neni 17

Kryetari, sekretari dhe anëtarët e Komisionit në përbërje të përhershme kanë të drejtë në kompensim për punë në komision komunal zgjedhor.

Kryetari dhe anëtarët e këshillave zgjedhor mund të realizojnë të drejtë në kompensim në pajtim me vendimin e organit kompetent për zbatimin e zgjedhjeve.

Zëvendësit, përfaqësuesit a autorizuar të listave zgjedhore të konfirmuara në komisionin komunal zgjedhor në këshillat zgjedhor, mund të realizojnë kompensimin në pajtim me Vendimin e organit kompetent për zbatimin e zgjedhjeve.

Personat që kryejnë punët profesionale, administrative dhe teknike për nevojat e Komisionit kanë të drejtë në kompensim.

Lartësinë e kompensimit për të gjithë personat e lartshënuar në nenin 13 përcakton organi kompetent për zbatimin e zgjedhjeve proporcionalisht kohës së kaluar në punë, kompleksitetit dhe vëllimit të punëve të kryera.

Neni 18

Komisioni ka xhiro llogarinë e vet.

Për të gjitha pagesat nga llogaria e Komisionit, urdhërdhënësi është kryetari i Komisionit.

Neni 19

Mbi seancat e Komisionit mbahet dhe hartohet procesverbali.

Procesverbali përmban të dhënat kryesore mbi punën në seancë, propozimet e dhëna dhe vendimet dhe konkludimet e sjella në seancë, si dhe pjesëmarrësit në diskutim.

Procesverbali duhet të përfshijë rezultatet e votimit për çështje të veçanta.

Anëtari i Komisionit i cili ka ndarë mendimin e tij për çështje të caktuara, mund të kërkojë që deklaratat përkatëse të ekspozimit të tij të futen në procesverbal.

Procesverbalin e miratuar nënshkruan kryetari i komisionit, anëtarët e Komisionit dhe sekretari i Komisionit.

Neni 20

Komisioni siguron ruajtjen e akteve zgjedhore dhe raporteve mbi rezultatet e zgjedhjeve me materialin zgjedhor dhe trajtimin e këtyre materialeve në përputhje me ligji.

Mbi ruajtjen e vulës dhe vulës katrore të protokollit përkujdeset sekretari i komisionit.

Neni 21

Në Komision mbahet regjistri i protokollit, rregullohet dhe ruhet dokumentacioni, i cili trajtohet në përputhje me rregulloret.

Neni 22

Të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punën e Komisionit, e të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, mund të rregullohen me vendim të veçantë apo me konkludim të Komisionit në përputhje me këtë rregullore.

Neni 23

Me sjelljen e kësaj rregullore pushon së vlejuri Rregullorja e Komisionit komunal zgjedhor të Tuzit numër 09/19 e cila është sjellë në seancë prej më 09.01.2019.

Neni 24

Kjo rregullore hynë në fuqi me ditën e sjelljes dhe do të publikohet në internet faqen e KKZ të Tuzit.

KOMISIONI KOMUNAL ZGJEDHOR

Numër: 08/20
Tuz , 01.07.2020

SEKRETARI,
Husein Đoković d.v.

V.V.

KRYETARI,
Edmond Ujkaj d.v.